



Me qëllim të unifikimit të komunitetit Egjiptian/ Ashkali për zgjedhjet e rregullta komunale të vitit 2021, bashkëpunimit politik të komunitetit të ndarë formalisht, orientimit e gjithë potencialit politik të problemet konkrete të komunitetit, partitë politike IRDK, PAI, PLE, PDAK dhe LpB, me datën ___/___/2021 lidhin

MARRËVESHJE KOALICIONI

Për Zgjedhjet Lokale

E lidhur më ___ / ___ / 2021, në _____ ndërmjet :

1. Iniciativës së Re Demokratike e Kosovës – IRDK, e përfaqësuar nga kryetari **z.Elbert Krasniqi**,
2. Partisë së Ashkalive për Integrim – PAI, e përfaqësuar nga deputeti **z.Bekim Arifi**,
3. Partisë Liberale Egjiptiane – PLE, e përfaqësuar nga kryetari **z.Veton Berisha**,
4. Partisë Demokratike të Ashkalive të Kosovës – PDAK, e përfaqësuar nga kryetari **z.Danush Ademi**,
5. Lëvizjes për Bashkëveprim -LpB, e përfaqësuar nga kryetari **z.Blerim Haliti**

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

Objekti i marrëveshjes është lidhja e koalicionit parazgjedhor për zgjedhjet lokale të 17 tetorit të vitit 2021

Neni 2

Emri i koalicionit

Emri i koalicionit të partive politike: IRDK, PAI, PLE, PDAK dhe LpB është **Lëvizja e Bashkuar e Egjiptianëve dhe Ashkalive** (në vijim koalicioni).

Neni 3

Deklarimi i koalicionit

Partitë politike: IRDK, PAI, PLE, PDAK dhe LpB, në afatin e përcaktuar nga KQZ, deklarojnë koalicionin parazgjedhor në KQZ.

Neni 4 Komunat

Koalicioni do të garoj në Zgjedhje për Asamble komunale në komunën e Ferizajt, Gjakovës, Fushë Kosovës, Pejës, Lipjanit, Istogut, Prizrenit, Klinës, Mitrovicës dhe Rahovecit.

Neni 5 Lista e kandidatëve për Asamble Komunale

1. Renditja partiake e kandidatëve të koalicionit, në dhjetëshen e parë të listës së kandidatëve për asamble komunale, duke e respektuar kuotën gjinore, do të jetë si në vijim:

- Komuna e Ferizajt:
 - o 1.PAI, 2.PDAK, 3.LpB, 4.PDAK, 5.LpB, 6. PAI, 7.LpB, 8.PAI, 9.PDAK, 10.IRDK.
- Komuna e Gjakovës:
 - o 1.PLE, 2.IRDK, 3.PLE, 4.IRDK, 5. PLE, 6.IRDK, 7.PLE, 8.IRDK, 9.PLE, 10.PDAK.
- Komuna e Fushë Kosovës:
 - o 1.PLE, 2.PAI, 3.IRDK, 3.PDAK, 5.LpB, 6.PLE, 7.PAI, 8.IRDK, 9.PDAK, 10. LpB
- Komuna e Pejës:
 - o 1.IRDK, 2.PLE, 3.IRDK, 4.PLE, 5.IRDK, 6.PLE, 7.IRDK, 7.PLE, 9.IRDK, 10.PLE
- Komuna e Lipjanit:
 - o 1.PAI, 2.PDAK, 3.LpB, 4.PAI, 5.PDAK, 6.LpB, 7.PAI, 8.PDAK, 9.LpB, 10.PAI.
- Komuna e Istogut:
 - o 1.IRDK, 2.PLE, 3.IRDK, 4.PLE, 5.IRDK. 6.PLE, 7.IRDK, 8.PLE, 9.IRDK, 10.PLE
- Komuna e Prizrenit:
 - o 1.IRDK, 2.PAI, 3.PDAK, 4.PLE, 5.IRDK, 6.PAI, 7.PDAK, 8.PLE, 9.IRDK, 10.PAI
- Komuna e Klinës:
 - o 1.IRDK, 2.PLE, 3.IRDK, 4.PLE, 5.IRDK, 6.PLE, 7.IRDK, 8.PLE, 9.IRDK, 10.PLE
- Komuna e Mitrovicës:
 - o 1.LpB, 2.PDAK, 3.IRDK, 4.LpB, 5.PDAK, 6.IRDK, 7.LpB, 8.PDAK, 9.IRDK, 10.LpB
- Komuna e Rahovecit:

- 1.IRDK, 2.LpB, 3.IRDK, 4.LpB, 5.IRDK, 6.LpB, 7.IRDK, 8.LpB, 9.IRDK, 10. LpB

2. Secili kandidat i Koalicionit për asamble komunale duhet të nënshkruaj deklaratën me këtë përmbajtje:

Unë _____, i nominuar si kandidat për Asamble komunale në komunën e _____, nga koalicioni Lëvizja e Bashkuar e Egjiptianëve dhe Ashkalive, deklaroj se:

- Gjatë fushatës parazgjedhore, dallimet në mes partive politike IRDK, PAI, PLE, PDAK dhe LpB, nuk do të jenë pjesë e fushatës sime.
- Nëse arrijë të jem pjesë e Asamblesë Komunale, Nënkyetar për Komunitete, Drejtor i ndonjë Drejtorie Komunale, Anëtar i Komitetit për Komunitete apo Komitetit për Siguri në Bashkësi, atëherë nuk do të mbajë asnjë pozitë në ndonjë parti politike dhe nuk do të jem pjesë e asnjë liste zgjedhore në zgjedhjet parlamentare.

Neni 6

Mbështetja e kandidatëve për Kryetar të komunës

Koalicioni, në rundin e parë të votimit, mbanë qëndrim neutral për kandidatët për kryetar të komunës në të gjitha komunat.

Në balotazh, në secilën komunë, mbështet kandidati për kryetar komune me subjektin e të cilit Koalicioni arrin marrëveshje. Nëse koalicioni nuk arrin pajtueshmëri për mbështetje të kandidatit për kryetar komune atëherë subjektet politike që e përbëjnë koalicionin janë të lira të zgjedhin për të mbështetur kandidat të caktuar për kryetar të komunës.

Neni 7

Përzgjedhja e komisionereve

Numri i përcaktuar i komisionereve për koalicionin nga Komisioni Komunal Zgjedhor ndahet proporcionalisht me subjektet që janë pjesë e koalicionit bazuar në përqindjen e votave për secilin subjekt në zgjedhjet e fundit.

Neni 8

Financimi

- Shpenzimet financiare për regjistrim të koalicionit në KQZ dhe ushqimin për komisioner në ditën e zgjedhjeve, bëhet si në vijim:
 - IRDK për komunat: Gjakovë, Pejë, Istog, Rahovec, Klinë
 - PAI për komunat: Ferizaj, Lipjan, Fushë Kosovë, Mitrovicë
- Shpenzimet e materialeve promovuese dhe të tubimeve parazgjedhore i bëjnë subjektet politike, kandidatët e të cilëve janë bartës të listës.

Neni 9
Përfaqësimi i koalicionit në organet komunale

Në komunat ku janë fituar vende në asamble komunal bëhet balancimi i përfaqësimit të subjekteve që janë pjesë e koalicionit për pozitën e nënkryetarit për komunitete, udhëheqje e Drejtorive nëse është e mundshme dhe në komitete duke u bazuar në radhitjen e përkatësisë politike në Listën e kandidatëve të përcaktuar në Nenin 5, pika 1.

Neni 10
Këshilli koordinues

Me qëllim të koordinimit të këshilltarëve të koalicionit të zgjedhur nëpër komuna të ndryshme, formohet Këshilli koordinues komunal i Egjiptianëve dhe Ashkalive. Roli dhe mënyra e funksionimit definohet me Statutin e Këshillit.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Marrëveshja hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e palëve.

Neni 12
Palët nënshkruese

Kjo marrëveshje është përpiluar në pesë (5) kopje origjinale, të gjitha të nënshkruara nga palët, ku secila palë merr një kopje origjinale.

Elbert KRASNIQI, IRDK	_____	__ / __ / 2021
Bekim ARIFI, PAI	_____	__ / __ / 2021
Veton BERISHA, PLE	_____	__ / __ / 2021
Danush ADEMI, PDAK	_____	__ / __ / 2021
Blerim HALITI, LpB	_____	__ / __ / 2021